



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 260/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Laziç dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Istog, për shkak të personave të pa autorizuar në Qendrën e Votimit QV, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë.

Arsyetim

Me datë 08.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK ku pretendohet se në qytetin e Istogut, në fshatin Gurakoc, në Qendrën e Votimit QV afër Vendvotimit VV nr.0604C aktivistët e subjektit politik LDK në mënyrë të pa autorizuar janë futur dhe i kanë penguar votuesit me rastin e votimit, ku në vendin e ngjarjes kanë dalur Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës. Parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 36 parag.1 pika a, b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga pretendimet ankimore të cekura, nuk mund të vërtetohet ajo për të cilin deklarohet pala ankuese në ankesën e saj, pasi që nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi. Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar dhe se për këtë arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar sipas nenit 3.6 pika c) e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 260/2014 më datën 11.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*